

## **SOVRANITETI PARLAMENTAR BRITANIK (ÇËSHTJA BREXIT)**

<b>1. HYRJE</b>	<b>3</b>
<b>2. ROLI I GJYKATËS SUPREME (SUPREME COURT)</b>	<b>4</b>
<b>3. STATUSI I PARLAMENTIT (NË ÇËSHTJEN BREXIT)</b>	<b>5</b>



## 1. Hyrje

Sovraniteti parlamentar është një parim i kushtetutës së Mbretërisë së Bashkuar. Ajo e bën Parlamentin autoritetin suprem ligjor në Britaninë e Madhe, i cili mund të krijojë ose t'i japë fund çdo ligji. Në përgjithësi, gjykatat nuk mund të anashkalojnë legjislacionin e tij dhe asnjë Parlament nuk mund të miratojë ligje që parlamentet e ardhshme nuk mund ta ndryshojnë. Sovraniteti parlamentar është pjesa më e rëndësishme e kushtetutës së Mbretërisë së Bashkuar.

Kur i referohemi Mbretërisë së Bashkuar shpesh dëgjojmë të thuhet që ka 'kushtetutë të pashkuar', por kjo nuk është saktësisht e vërtetë. Mund të mos ekzistojë një tekst i vetëm (single text), si në SHBA apo vende të tjera, por pjesë të rëndësishme të saj janë të shkruara dhe të sanksionuara. Pjesë të rëndësishme të saj janë të miratuara në formë e ligjeve të miratuara në Parlament - të njohura edhe Statute Law. Për saktësi në referim duhet të themi që, kushtetuta e Mbretërisë së Bashkuar mund të përshkruhet si 'pjesërisht e shkruar dhe tërësisht e pabotuar' (në këtë rast përdoret fjala Uncodified Single Text që do të thotë se Mbretëria e Bashkuar nuk ka një kushtetutë të vetme të shkruar).

Gjatë viteve, Parlamenti ka miratuar ligje që kufizojnë zbatimin e sovranitetit parlamentar. Këto ligje pasqyrojnë zhvillimet politike brenda dhe jashtë Britanisë së Madhe. Ato përfshijnë: a. Transferimi i pushtetit tek organet si Parlamenti Skocez dhe Kuvendi i Uellsit; b. Ligji për të Drejtat e Njeriut 1998; c. Hyrja e Mbretërisë së Bashkuar në Bashkimin Evropian në vitin 1973; ç. Ligjin e 2005 (Constitutional Reform Act) për ushtrimin e funksioneve të gëzuara më parë nga Dhoma e Lordëve (Law of Lords) tashmë nga ana Gjykatës së Lartë të Mbretërisë së Bashkuar (në vitin 2009). Ky Akt me natyrë kushtetuese zëvendësoi rolin e më parshëm të Dhomës së Lordëve në çështje specifike.

***Të gjitha këto më sipër nuk çenojnë thelbësisht parimin e sovranitetit parlamentar, pasi, në teori të paktën, Parlamenti mund të shfuqizojë ndonjë nga ligjet që zbatojnë këto ndryshime.***

Pak rreshta për reformat e Dhomës së Lordëve (House of Lord Reforms). Deri në korrik 2006, roli i kryetarit në Dhomën e Lordëve u krye nga Lord Chancellor, por në përputhje me angazhimin e Qeverisë për të rishikuar detyrat e ndryshme të Lord Chancellor, Akti i Reformës Kushtetuese 2005 (Constitutional Reform Act 2005) krijoi postin e "Drejtuesit të Dhomës së Lordëve" (Speaker of the House of Lords) dhe e mundësoi atë të mbahej nga një Anëtar i Lordëve. Një Komision i zgjedhur i Dhomës së Lordëve, i kryesuar nga Lord Lloyd i Berwick, u raportoi Lordëve në

dhjetor 2005 dhe rekomandoi fuqitë, mënyrën e zgjedhjes dhe titullin e "Drejtuesit të ri" (Lord Speaker). Kryetari aktual i Lordëve është Baronessa D'Souza. Në vitin 2012, një Ligj i Dhomës së Lordëve (të paraqitur nga qeveria e koalicionit) nuk u miratua për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme parlamentare. Megjithatë, dy ligje të propozuara nga dy anëtarë në mënyrë individuale çuan në miratimin e ligjit në 2014 dhe 2015. Aktet sigurojnë që anëtarët e Dhomës të dalin në pension ose të japin dorëheqjen nga Dhoma; ato lejojnë përjashtimin e anëtarëve të Dhomës në rrethana të caktuara; dhe i japin të drejtë Dhomës për të dëbuar ose pezulluar anëtarët e saj.

## 2. Roli i Gjykatës Supreme (Supreme Court)

Për herë të parë në historinë kushtetuese të Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata Supreme (në vitin 2005), përmes miratimit të Aktit të Reformës Kushtetuese nga Parlamenti Britanik, morri përsipër rolin gjyqësor të Dhomës së Lordëve. Gjykata Supreme konsiderohet shkalla e fundit e Apelit në Mbretërinë e Bashkuar si për çështjet civile ashtu dhe për ato penale (për Anglinë, Uellsin dhe Irlandën e Veriut); kjo Gjykatë dëgjon rastet e rëndësishme më të madhe publike ose kushtetuese që ndikojnë në të gjithë popullsinë.<sup>1</sup> Ajo ka në këtë rast një juridiksion të posaçëm kushtetues. Gjykata Supreme nga 1 Tetor 2009, ka marrë funksionet gjyqësore të Dhomës së Lordëve, të ushtruar nga Lords of Appeal in Ordinary.<sup>2</sup> Për shkak të doktrinës së sovranitetit parlamentar, Gjykata Supreme është shumë më e kufizuar në kompetencat e saj të shqyrtimit gjyqësor sesa gjykatat kushtetuese apo supreme të disa vendeve të tjera, pasi në asnjë rast kjo Gjykatë nuk mund të shfuqizojë legjislacionin primar të miratuar nga Parlamenti. Megjithatë, mund të shfuqizojë legjislacionin sekondar, nëse, për shembull, ai është miratuar ultra vires me kompetencat e dhëna nga legjislacioni parësor.

*Sipas nenit 4 të Aktit për të Drejtat e Njeriut të vitit 1998, Gjykata Supreme, ashtu si disa gjykata të tjera në Mbretërinë e Bashkuar, mund të bëjë një deklaratë të papajtueshmërisë, duke treguar se beson që legjislacioni objekt i deklaratës është i papajtueshëm me një nga të drejtat në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

---

<sup>1</sup>The Supreme Court is the final court of appeal in the UK for civil cases, and for criminal cases from England, Wales and Northern Ireland. It hears cases of the greatest public or constitutional importance affecting the whole population.

<sup>2</sup>The Constitutional Reform Act 2005 (c 4) is an [Act](#) of the [Parliament of the United Kingdom](#), relevant to [UK constitutional law](#). It provided for a [Supreme Court of the United Kingdom](#) to take over the existing role of the [Law Lords](#) as well as some powers of the [Judicial Committee of the Privy Council](#), and removed the functions of [Speaker](#) of the [House of Lords](#) and Head of the [Judiciary of England and Wales](#) from the office of [Lord Chancellor](#).

*Një deklaratë e tillë mund të zbatohet për legjislacionin primar ose sekondar. Legjislacioni nuk është përmbysur nga deklarata, dhe as Parlamentit e as qeverisë nuk i kërkohet të bien dakord me ndonjë deklaratë të tillë. Megjithatë, nëse pranojnë një deklaratë, ministrat mund të ushtrojnë kompetenca sipas nenit 10 të Aktit për të ndryshuar legjislacionin me instrument ligjor, për të hequr papajtueshmërinë ose për të kërkuar nga Parlamenti që të ndryshojë legjislacionin.*

Disa juristë Britanikë vlerësojnë se Gjykata Supreme do të vazhdojë punën e Komisionit Gjyqësor të Dhomës së Lordëve, ndërsa, disa të tjerë argumentojnë se zhvillimi i gjykatave të tjera të larta në mbarë botën, sidomos Gjykata Supreme e SHBA-së, na kujton se në fund të fundit roli i ardhshëm i Gjykatës Supreme të Mbretërisë së Bashkuar qëndron në duart e vetë gjyqtarëve. Për më tepër, Gjykata Supreme vetëm do të shqyrtojë ato raste që kanë të bëjnë me “çështje të ligjit me rëndësi të përgjithshme publike”. Kjo tregon se kjo Gjykata është e gatshme të konsiderohet një gjykatë kushtetuese.

***Roli i Gjykatës së Lartë mund të jetë tregues se Mbretëria e Bashkuar mund të jetë duke u larguar nga epërsia teorike absolute parlamentare drejt një demokracie kushtetuese.***

### **3. Statusi i Parlamentit (në çështjen Brexit)**

Në nenin 50/par. 1 TBE: “Çdo Shtet Anëtar mund të vendosë të dalë nga Bashkimi, në përputhje me kërkesat kushtetuese të veta”. Qeveria britanike pretendonte se kishte kompetencën prerogative të Kurorës për të hyrë dhe për t’u tërhequr nga traktatet dhe për rrjedhojë i përkiste autoriteti ligjor për të vënë në lëvizje nenin 50 TBE, pa miratimin e Parlamentit britanik. Për këtë çështje, më 24 janar 2017 u shpreh Gjykata e Lartë e Mbretërisë së Bashkuar në vendimin Miller.<sup>3</sup> Pretendimi i Sekretarit të Shtetit në bazë të kompetencës prerogative të Kurorës ishte se: *ministrat kanë të drejtë të ushtrojnë këtë pushtet edhe në raport me Traktatet e BE-së.* Për këtë arsye: *Qeveria mund të bëjë njoftimin pa pasur nevojë për ndonjë legjislacion paraprak. Pas dhënies së njoftimit deri në fund të marsit 2017, ministrat do t’i dërgonin Parlamentit atë që njihet si “Akti i Madh i Shfuqizimit”.* Ky Akt do të shfuqizojë Aktin e vitit 1972 dhe, kudo që të jetë e volitshme, ai do ta shndërrojë legjislacionin ekzistues të BE-së në legjislacion vendas së paku për një periudhë tranzitore. Në bazë të nenit 50 të TBE-së, tërheqja do të ndodhë jo më vonë se dy

---

<sup>3</sup>In its **judgment in Miller**, the **Supreme Court** reached the key conclusion: that an Act of Parliament is needed before Brexit can be triggered.

vjet pas njoftimit (përveç nëse kjo periudhë zgjatet me marrëveshje unanime midis Shteteve të tjera Anëtare) dhe ka për qëllim që në këtë pikë Akti i Madh i Shfuqizimit të hyjë në fuqi. Gjykata e Lartë vendosi në shumicë kundër Qeverisë, së cilës do t'i duhet miratimi nga Parlamenti për të vënë në lëvizje procesin e tërheqjes nga BE. Parlamenti Britanik miratoi për këtë qëllim Aktin e BE-së 2017. Gjykata e Lartë parashtroi arsye të rëndësishme të mungesës së kompetencës për ushtrimin e prerogativës Mbretërore nga Qeveria mbi Traktatet e BE-së, të mbështetura në raportin midis Parlamentit dhe ekzekutivit, natyrën e Aktit 1972 dhe statusit të së drejtës së BE-së në sistemin e brendshëm britanik të së drejtës. Gjykata e Lartë u shpreh se prerogativa Mbretërore përfshin kompetencat e mbetura të Kurorës të cilat ushtrohen nga ministrat, me kushtin që ushtrimi i këtyre kompetencave të jetë në përputhje me legjislacionin parlamentar. Në një vendim të Lordi Browne-Wilkinson është bërë e qartë se: *qëllimet e ministrave nuk janë ligj dhe gjykatat nuk mund të vazhdojnë me supozimin se ata domosdoshmërisht do të bëhen ligj*. Në përputhje me këtë arsyetim, shumica e gjyqtarëve të çështjes u shprehen se: *do të ishte në kundërshtim me parimet tradicionale dhe themelore që një ndryshim kaq i gjerë i marrëveshjeve kushtetuese të Mbretërisë së Bashkuar të miratohet vetëm me vendim ministror ose me veprime ministrore; një ndryshim i madh në marrëveshjet kushtetuese në Mbretërinë e Bashkuar nuk mund të arrihet vetëm nga një ministër dhe duhet të zbatohet në mënyrën e vetme që një kushtetuta e Mbretërisë së Bashkuar, përkatësisht me legjislacionin parlamentar*.

***Çështja Miller vlerësohet si triumfi i Parlamentit mbi ekzekutivin; triumfi parimeve kushtetuese dhe Parimit të Sovranitetit Parlamentar.<sup>4</sup>***

---

<sup>4</sup>Mark Elliot "The Supreme Court's Judgment in Miller", <https://publiclawforeveryone.com/2017/01/25/analysis-the-supreme-courts-judgment-in-miller>